

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2164/ Prot.

Durrës, më 24.09.2025

V E N D I M

Nr. 105, datë 24.09 2025

PËR

**"MIRATIMIN E FORMATIT TË CERTIFIKATËS PËR PROGRAMIN E STUDIMIT
"FORMIMI I VAZHDUAR NË FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJI", TË FAKULTETIT
TË EDUKIMIT, UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës"**

Bazuar në ligjin, Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike"; në Udhëzimin Nr.10, datë 30.02.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" i ndryshuar me Udhëzimin Nr.14, datë 21.06.2022 dhe Udhëzimin Nr.19, datë 31.08.2023; në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD-së; në relacionin e Drejtorisë së Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave me Nr. 1751/3 prot., datë 23.09.2025, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e formatit të certifikatës për programin e studimit "Formimi i Vazhduar në Fushën Psiko-Pedagogji", të Fakultetit të Edukimit, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesi i Njësisë Kryesore i Fakultetit të Edukimit
 - Drejtorja e Kurrikulës, Cilësisë dhe Statistikave
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi

